

Pengesa funksionale

Ju që keni një pengesë funksionale sipas ligjit keni të drejtë për përkujdesje dhe mbështetje nga Prefektura për shëndetësi. Habilitimi dhe rehabilitimi, pranë prefekturës për shëndetësi për fëmijë, të rinjë dhe të rritur do të të jap ty me pengesa funksionale mjetet të cilat të ndihmojnë në përditshmërinë tënde në perspektivën jetësore. Ata i shqyrtojnë nevojat tuaja dhe marrin vendime, gjithnjë që ti të ndjen një siguri dhe mbështetje në jetesën tënde. Ndhimesat për habilitim dhe rehabilitim jepen përmes njësive të shumta nga prefektura shëndetësore. Komuna e juaj ose qendra shëndetësore mund të ju jep këshilla dhe ndihmë në lidhje me këtë.

Qendra për të pamurit

Ju ofron mundësin pos tjerash që të provoni dhe ushtroni me mjetet ndihmëse. Ju do të merrni informacion, mbështetje dhe udhëzime për shum lëmenj të ndryshëm.

Qendra për të dëgjuarit

Përbëhet nga njësia për dëgjim dhe njësia për shurdhësi, mjetet teknike të dëgjimit dhe pranimin audionom. Ata bëjnë kontrolla dhe ofrojnë mjete dhe mundësi për ty që ke dëgjimin e dobësuar apo je i shurdhër, ke kombinim të dobësimit të dëgjimit dhe të pamurit dhe/ose tinnitus.

Qendra e përkthimit

Të ofron mundësi të përkthimit ty që je i shurdhër, i shurdhër dhe i vërbër ose je i rritur dhe i shurdhër/ keni dëgjimin dukshëm të dobësuar. Ju keni të drejtë për përkthim me gjuhen e shenjave dhe përkthim përmes të shkruarit në shumicën e situatave në jetën e përditshme. Shërbimi i përkthimit është falas dhe porositet përmes qendrës së përkthimit në prefekturën shëndetësore.

Në rast të nevojës urgjente për përkthyes në rast të alarmimit, thirrni numrin 112.

Qendra për mjetet ndihmëse

Ka në dispozicion të gjitha mjetet ndihmëse për fëmijë dhe të rinjë deri 18 vjet. Për të rriturit qendra për mjetet ndihmëse afron shërbime me karrigat elektrike lëvizëse, me mjete ndihmëse të komunikacionit dhe mjete ndihmëse kognitive, mjete ndihmëse për mjekim dhe ushtrime dhe mjete të avancuara për përshtatjen e uljës.

Këshillëdhënie përmes telefonit me tekst

Ju që keni dëmtime të të dëgjuarit, jeni i shurdhër dhe me të meta në të folur ju ofrohet ndihmë. Është qendra e alarmimit (SOS) që bën këtë shërbim për juve dhe numri i telefonit për këtë shërbim është 020 – 33 00 00.

Prefektura shëndetësore e Kronoberget përpjeket që në mënyra të ndryshme të ju ofroj informacion i cili i është përshtatur sipas nevojës së grupeve të ndryshme. Ne ju ofrojmë për shëmbull informacion të lexueshëm, që lexohet lehtë, gjuhen e shenjave dhe një pjesë të informacionit të përkthyer në gjuhë tjera. Lexoni më shumë në webb faqen tonë.

Qka është invaliditeti?

Të gjithë njerëzit me pengesa funksionale nuk janë të invalidizuar. Invaliditeti shfaqet kur ambienti rrethues nuk i është përshtatur atij që ka pengesa funksionale. Nëse dëshironi të njohtoheni me programin politik të prefekturës shëndetësore për invalidet mund të porositni këtë përmes web faqës sonë nën rubriken "snabbval" (zgjidhje e shpejtë), përmes shërbimeve të internetit, mund të porositni fletushka të shtypura ose duke thirrur në numrin 0407-58 85 64.

Njësia e invalidëve

Ndodhet në spitalin qendror në Växjö dhe punon e ngarkuar me detyrë nga këshilli invalidor. Njësia e invalidëve e përcjell zhvillimin brenda pjesës së invalidëve si në pikpamje kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare dhe punon në bashkpunim të ngushtë me organizatat e invalidëve në prefekturë. Puna është e mbështetur në programin politik të prefekturës për shëndetësi për invalidët në drejtimin e arritshmërisë, mundësisë së afrimit, bashkëveprimit dhe procedimit.

Këshilli i invalidëve

Përbëhet nga disa politikan të vendosur nga komisione të ndryshme parlamentare si përfaqësues të zgjedhur nga lëvizja e invalidëve. Këshilli i invalidëve është këshilldhënës për kryesin e prefekturës shëndetësore në qeshtjet që kanë të bëjnë me invalidët.

Lëvizja e invalidëve Idé- & KunskapsCentrum (Ide – Qendra për dituri)

Është lëvizja e grumbulluar e invalidëve në prefekturën e Kronobergut. Organizata punon për të krijuar dhe ruajtur një lëvizje unike të invalidëve me përfaqësues që angazhohen dhe janë të dijshtëm dhe kanë shtrirje në mesin e të gjithë atyre që kanë pengesa funksionale në të gjitha moshat dhe me përkatësi të ndryshme etnike dhe kulturore.

Adresa: Västergatan 15, 352 31 Växjö Telefoni: 0470-71 10 50 info@handikappkunskap.se

Në webfaqen www.hso.se nën rubriken [rättsdatabasen](#) mund të merrni udhëzime për ligjet dhe rregullat për personat me pengesa funksionale në 13 gjuhë të ndryshme.